



REBULIKA E SHQIPERISE
BASHKIA LEZHE

Nr. _____ Prot

Data ____/____/ 2026

PROCESVERBAL – Tipi i kontratës - Mall

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

OBJEKTI I PROCEDURËS: “Blerje karburant per nevoja te Bashkise Lezhe”.

- **Loti I-re:** Blerje GAZOIL $\leq 10\text{PPM}$,

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV): 09100000-0;

VLERA E FONDIT LIMIT: **68,915,896** (gjashtëqind e tetëdhjetë milion e nentëqind e pesëmbëdhjetë mijë e teteqind e nentëdhjetë e gjashtë) **Lek pa TVSH** ose **716,530.42** (shtatëqind e gjashtëmbëdhjetë mijë e pesëqind e tridhjetë pike dyzet e dy) Euro pa Tvsh. Kursi i këmbimit sipas Bankës së Shqipërisë datë 20.01.2025 është 96.18 Lekë.

Loti I-re: “Blerje GAZOIL $\leq 10\text{PPM}$ ”, si fond limit, vlere te pritshme e kontratës prej **67,227,569.8** (gjashtëdhjetë e shtatë milion e dyqind e njetë e shtatë mijë e pesëqind e gjashtëdhjetë e nente pike tete) **Lek pa TVSH** ose **698,976.6** (gjashtëqind e nentëdhjetë e tete mijë e nentëqind e shtatëdhjetë e gjashtë pike gjashtë) **Euro pa Tvsh**. Kursi i këmbimit sipas Bankës së Shqipërisë datë 20.01.2025 është 96.18 Lekë.

Ne vijim AK, bazuar ne nenin 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor Bashkia Lezhe ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas Shtojcës 9;*

b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 4;*

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, nenit 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1. Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale (nëse është e aplikueshme):

2.2.1 Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare 2022, 2023 dhe 2024, ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 40 % e vlerës së fondit limit objekt prokurimi.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë: Kjo vlerë është përcaktuar referuar nenit 47, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Shënim: Duke qenë se aktet ligjore dhe nënligjore parashikojnë një marzh për vlerën e xhiros që mund të kërkohej, autoritetet/entet kontraktore duhet të argumentojnë vlerën e kërkuar të xhiros brenda këtij marzhi.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në nenin 29, pika 1, të Ligjit Nr. 8438, datë 28.12.1998 Për Tatimin mbi të Ardhurat, i ndryshuar, ku parashikohet se: “Çdo tatimpagues pergatit deklaraten vjetore të të ardhurave të tatueshme në formën e përcaktuar në udhëzimin e Ministrisë të Financave në zbatim të këtij ligji. Tatimpaguesit paraqesin deklaraten vjetore në organet tatimore brenda datës 31 mars të vitit pasardhës, duke paraqitur në të njëjtën kohë bilancin kontabel, së bashku me anekset e tij, si dhe çdo të dhënë tjetër të përcaktuar në udhëzimin e Ministrisë të Financave në zbatim të këtij ligji.”

Shënim: Duke qenë se operatorët ekonomikë kanë afat për paraqitjen e deklaratës vjetore të vitit 2025 në organet tatimore deri në datën 31 mars të vitit 2026, Njësia e Prokurimit nuk mund të vendosë kriterin që operatorët ekonomikë të paraqesin deklaraten vjetore për vitin 2025 për këtë procedure të publikuar në muajin janar 2026, pasi do të përjashtonte dhe kufizonte në pjesëmarrje operatorët ekonomikë që nuk kanë dorëzuar akoma deklaraten vjetore për vitin 2025.

2.2.2 Një dokument që vërteton se subjekti i ka plotësuar të gjitha detyrimet të maturuara të taksave dhe tarifave vendore të vitit 2025, lëshuar nga Administrata e Qeverisjes Vendore. (Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë, çdo anëtar i grupit duhet të dorëzojë këtë dokument.

Shënim: Kjo kërkesë përmbushet nepermjet paraqitjes nga operatorët ekonomikë të formularit përmbledhës të vetedeklarimit sipas shtojcës përkatëse të DST-së dhe dokumentacioni i kërkuar duhet të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar, i pari përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe fillimit të afatit të ankimimit.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 1 dhe 3, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, si dhe nenit 43, nenit 41, pika 5/ c), të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” dhe në ligjin nr.9632, datë 30.10.2006 “Për Sistemin e Taksave Vendore” i ndryshuar, në ligjin nr.9920 datë 19.05.2008 “Per procedurat tatimore” i ndryshuar, neni 3.1/a, b, c dhe neni 40, në ligjin nr.131/2015 “Per QKB” i ndryshuar, si dhe në ligjin nr.9723 datë 03.05.2007 “Per QKR” i ndryshuar.

Meqenese operatorët ekonomik kanë detyrimin të paguajnë të gjitha detyrimet e taksave dhe tarifave vendore, në vendet që ushtrojnë aktivitetin e tyre, atëherë operatorët ekonomikë pjesëmarrës duhet të vërtetojnë se i kanë likuiduar këto detyrime nëpërmjet paraqitjes së vërtetimit të lëshuar nga Administrata e Qeverisjes Vendore.

2.3 Kapaciteti teknik:

2.3.1 Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më të vogël se 40 % të vlerës së fondit të limit të kësaj kontrate.

Këto furnizime të ngjashme duhet të vërtetohen me dokumentacionin si më poshtë:

a-Kur furnizimet e ngjashme janë realizuar me institucione shtetërore, Operatori ekonomik do ta vërtetojë duke paraqitur vërtetimin e lëshuar nga Institucioni shtetëror për realizimin e sukseshëm të kësaj kontrate/ ose dhe faturat tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara;

ose

b-Kur furnizimet e ngjashme janë realizuar me subjekte private Operatori ekonomik do ta vërtetojë duke paraqitur faturat tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, pika 4, dhe nenit 55, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 40 % të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

2.3.2 Subjekti duhet të jete i pajisur me leje të tregtimit të karburantit (Naftë D1) lëshuar nga institucionet përkatëse. Për të përmbushur këtë kriter OE duhet të paraqesin lejen përkatëse.

Argumentimi: Në bazë të pikës 2, të nenit të 77, të ligjit nr. nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, pika 5, shkronja a, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, në neni 4 të ligjit nr.8450, datë 24.2.1999 “Për përpunimin, transportimin dhe tregtimin e naftës, të gazit dhe nënprodukteve të tyre”, në VKM-ne

nr. 970, datë 2.12.2015 “Për përcaktimin e procedurave dhe të kushteve për dhënien e licencave për tregtimin e naftës bruto dhe nënprodukteve të saj” i ndryshuar me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që janë pajisur me leje të tregtimit të karburantit.

2.3.3 Operatori/et ekonomike ofertues duhet të kenë të punesuar të paktën 5 (pese) punonjës për periudhën Tetor 2025 – Dhjetor 2025, të vërtetuar me:

- Vërtetim të lëshuar nga Sigurimet shoqërore ose Administrata Tatimore, ku të specifikohet numri i punonjësve për secilin muaj, për periudhën Tetor 2025 – Dhjetor 2025.
- Listë pagesat e punonjësve sipas formatit që kërkohet nga legjislacioni në fuqi për periudhën Tetor 2025 – Dhjetor 2025.

Shenim: Kjo kërkesë permbushet nepermjet paraqitjes nga operatorët ekonomik të formularit permbledhes të vetedeklarimit sipas shtojcës përkatëse të DST-se dhe dokumentacioni i kërkuar duhet të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar, i pari përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe fillimit të afatëve të ankimit.

Argumentimi: Në bazë të pikës 1, 4 dhe 5 të nenit të 77, të ligjit nr. nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, pika 5, shkronja b dhe c, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë në dispozicion fuqinë punëtore të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit.

Deklarimi dhe regjistrimi i punonjësve në regjistrin e sigurimeve është një detyrim ligjor i punëdhënësit e parashikuar nga Kodi i Punës, për rrjedhojë çdo dëshmi me këtë kohështrirje është dokument vërtetues për qëndrueshmërinë e të punësuarve dhe përvojën e tyre, për sa kohë që ato janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës.

Punësimi i një numri të caktuar, si një nga kërkesat themelore të kualifikimit, përveç besueshmërisë së operatorëve ekonomik, përpiqet të kufizojë edhe problematikat sociale dhe shmangien e informalitetit në tregun e punës. Vendosja e kriterit të mesiperm për numrin minimal të punonjësve duke përfshirë dhe stafin teknik, është në përputhje me termat e references në të cilat kërkohet furnizim 24 orësh.

Sa më sipër, Nj P gjykon se në përcaktimin e numrit të punonjësve duhet marrë në konsideratë fakti se furnizimi me mall do të kryhet 24 ore në ditë pa ndërprerje për mjetet zjarrefikese, ndërkohë që duhet marrë në konsideratë edhe koeficientin e zëvendësimit të punonjësve për shkak të kohëzgjatjes maksimale të kohës së punës, pushimet javore dhe vjetore në përputhje me kodin e Punës.

Njesia e prokurimit vlerëson për funksionimin normal të stacionit të shitjes së karburanteve me pakicë, me shërbim 24 orë, nevojiten minimalisht 5 punonjës, duke mbajtur në konsideratë dispozitat ligjore të ligjit nr. 7961, datë 12.7.1995 “Kodi i punës i Republikës së Shqipërisë” i ndryshuar, në lidhje me orarin javor të punës (neni 83, 40 ore në javë), ditët e pushimit javor (neni 85), festat zyrtare (neni 86), pushimet vjetore (neni 92) dhe pushimet e tjera (neni 96).

2.3.4 Operatori ekonomik duhet të paraqese një vertetim të leshuar nga ISHTI, që subjekti ofertues ka tregtuar karburante sipas standarteve të legjislacionit Shqiptar dhe nuk ka patur penalitete për shkelje të cilesise për vitin 2025.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4 dhe 5 të nenit të 77, të ligjit nr. nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, pika 7 dhe 8 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë se kanë tregtuar karburante sipas standarteve të legjislacionit Shqiptar dhe nuk ka patur penalitete për shkelje të cilesise për vitin 2025.

Vendosja e këtij kriteri është bërë duke pasur në konsideratë parshikimet ligjore të ligjit nr.8450 datë 24.02.1999 “Për përpunimin, transportimin dhe tregtimin e naftës, të gazit dhe nënprodukteve të tyre”.

2.3.5 Bazuar në VKM Nr 561 datë 29.07.2016 “Per Standartizimin dhe disiplinimin e shpenzimeve të karburantit në njesite e qeverisjes së përgjithshme” i ndryshuar, Operatorët ekonomik pjesëmarrës duhet të ofrojnë një faqe menaxhimi të karburanteve (webpage), ku furnizimi dhe shpenzimi i karburantit për mjetet efektive të transportit të kryhet nëpërmjet kartës elektronike. Faqja e menaxhimit të karburanteve (webpage), duhet të ofrojë shërbimin e ngarkimit të sasisë së karburantit nga Operatori ekonomik drejt Autoritetit Kontraktor, me qëllim që rimbushja e kartave elektronike të personalizuar me targën e mjetit si dhe administrimi i sasisë së karburanteve të kryhet nga vete Autoriteti kontraktor. Mos ofrimi i shërbimeve të kërkuara më sipër në mënyrë elektronike nëpërmjet Faqes së menaxhimit të karburanteve (webpage), që ofron çdo operator ekonomik pjesëmarrës përben kusht për skualifikim. Për këtë operatori ekonomik duhet të paraqesë një dokument që provon se disponon një (webpage) faqe të menaxhimit të karburanteve.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, pika 7 dhe 8, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, VKM Nr 561 datë 29.07.2016 “Per Standartizimin dhe disiplinimin e shpenzimeve të karburantit në njesite e qeverisjes së përgjithshme” i ndryshuar, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë në dispozicion një (webpage) faqe të menaxhimit të karburanteve.

2.3.6 Operatori ekonomik duhet të disponojë të paktën një pikë të furnizimit me karburant në pronësi/ qira ose kontratë bashkëpunimi, në një distancë jo më shumë se 5 (pese) km nga qendra e qytetit të Lezhës.

a- Për të provuar kriterin e mësipërm OE duhet të paraqesë Çertifikatë/Vertetim Pronësie ose kontratë qiraje ose kontratë bashkëpunimi si dhe dokumentacionin e kërkuar në pikën c.

b- Për të vertetuar kriterin e distancës, KVO-ja, do të referohet ekstraktit të QKB të subjektit (vendndodhjes së ushtrimit të aktivitetit), nëpërmjet adresës elektronike të QKB-së.

c- Stacioni i mësipërm i tregimit të karburantit detyrimisht duhet të jetë i pajisur me:

- Vertetim teknik leshuar nga Organet e Miratuara të Vlerësimit të Konformitetit (OMVK),
 - Certifikatë e mbrojtjes nga zjarri nga M.Z.SH, të cilat duhet të jenë brenda afatit të vlefshmerisë datën e hapjes së ofertave.
-

-License me kod III.1.B "Per furnizimin me karburant te makinave ne nje stacion furnizimi"

Argumentimi: Në bazë të pikës 4 dhe 5, të nenit të 77, të ligjit nr. nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik" dhe nenit 40, pika 5, shkronja a, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik", me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë në nje pike te furnizimit me karburant ne pronesi/ qira ose kontrate bashkepunimi, ne nje distance jo me shume se 5 (pese) km nga qyteti i Lezhes.

Ky kriter eshte vendosur per te provuar disponueshmerine e pikes se karburantit nga operatori ekonomik dhe per te garantuar ekzekutimin me sukses te kontrates, nese operatori shpallet fitues. Percaktimi i distances prej jo me shume se 5 (pese) km nga qyteti i Lezhes eshte vendosur per te bere te mundur furnizimin e vazhdueshem dhe periodik te mjeteve te institucionit pa kosto ekstra ne karburant dhe burime njerezore.

2.3.7 Operatori ekonomik duhet të paraqese *dëshmi për rezultate të testimeve zyrtare*, te leshuara nga institucione te autorizuar qe vertetojne pajtueshmerine e produkteve me specifikimet teknike. Ne raport-analizat te perfshihen te gjithë treguesit e percaktuar ne specifikimet teknike.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik" dhe nenit 40, pika 6, shkronja c, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik", me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë me ane te testimeve zyrtare pajtueshmerine e produkteve me specifikimet teknike.

2.3.8 Operatori ekonomik duhet te disponoje certifikatat e mëposhtme:

ISO 9001:2015 Per sistemin e menaxhimit te Cilesise ose ekuivalentin e saj.

Shënim: *Certifikatat e mesiperme/ekuivalente duhet te jene te leshuar nga Institucione te certifikuara/akredituara ne Shqiperi ose tek ato nderkombetare dhe në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë, çdo anëtar i grupit duhet të dorëzoje keto certifikata ne perputhje me sherbimet qe ka marre persiper në marreveshjen e bashkepunimit.*

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 79, "Standardet e sigurimit të cilësisë, te Shëndetit dhe sigurise në punë dhe standardet e menaxhimit mjedisor " të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik", dhe nenin 39, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik". Referuar te objektit të kontratës që do të prokurohet, është e rendësishme që operatorët, të kryejnë veprimtarinë me standardet e kërkuara të cilësisë. Sistemi i menaxhimit të cilësië, eshte standarte që çdo subjekt juridik apo privat e ka qëllim në arritjen e suksesit. Këto certifikime lidhen ngushtësisht me objektin e kontratës përsa kohë do të pronohen edhe ekuivalentet e tyre dhe i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e kapaciteteve të operatorëve ekonomikë dhe të mundësisë së tyre për përmbushjen e plotë të kontratës.

2.3.9 Subjekti duhet të paraqesë deklaratë në bazë të së cilës merr përsipër :

- Furnizimin me karburante sipas standarteve ne fuqi,
 - Furnizimin me karburant detyrimisht me pistolette publike,
-

- Subjekti duhet të deklarojë, se merr përsipër furnizimin në stacione të shitjes së karburanteve me pakicë me shërbim 24 orë, me karte elektronike të personalizuar me targon e cdo automjeti të autoritetit kontraktor ose bot, sipas kërkesave të autoritetit kontraktor në momentin e lidhjes së kontrates. *(Deklarate nga subjekti ofetues.)*
- Subjekti ofertues duhet të deklarojë se merr përsipër furnizimin me karburant Makinerite e Renda (Eskavatoret) të Bashkisë Lezhe me shpenzimet e tij sipas kërkesave të Autoritetit Kontraktor. *(Deklarate nga subjekti ofertues),*
- Subjekti duhet të deklarojë se merr përsipër që të konvertojë të gjithë sasine e litrave të ndodhura në kartën elektronike të personalizuar me targon e mjetit ose bot në leng, deri në perfundimin e plote të kontrates, sipas nevojave të Autoritetit Kontraktor. Kartat elektronike duhet të jenë pa skadencë dhe të konsumueshem edhe gjatë vitit 2025. *(Deklarate nga subjekti ofetues),*

Argumentimi: Në bazë të pikës 4 dhe 5, të nenit të 77, të ligjit nr. nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, pika 8, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, ku parashikohet se: Autoriteti/enti kontraktor, përveç kërkesave të parashikuara në këtë nen, mund të përcaktojë kritere të tjera të veçanta, në varësi të objektit që prokurohet, të cilat i vlerëson të nevojshme për ekzekutimin me sukses të kontratës.

Është kërkuar që OE-te, të paraqesin deklarate që malli është sipas standarteve në fuqi, që të furnizohet me pistolette publike, furnizimin në stacione të shitjes së karburanteve me pakicë me shërbim 24 orë, furnizimin me karburant Makinerite e Renda (Eskavatoret) të Bashkisë Lezhe, si dhe të deklarojë se merr përsipër që të konvertojë të gjithë sasine e litrave të ndodhura në kartën elektronike të personalizuar me targon e mjetit ose bot në leng, deri në perfundimin e plote të kontrates, sipas nevojave të Autoritetit Kontraktor, me qellim që AK të sigurohet se operatori ekonomik fitues të ofrojë mall sipas nevojave të AK-se.

2.3.10 Operatoret ekonomike duhet të përgatisin ofertën në përputhje me nenin 45, pika 2, të VKM-se 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar.

2.3.11 Duke qenë se cmimi i bursës dhe kursi i kembimit është i ndryshueshem, Operatoret ekonomike duhet të referohen për ofertim cmimit të bursës të marre si reference për llogaritjen e fondit limit në datën 15.01.2026, duke shtuar edhe premion, dhe kursit të kembimit të bursës të marre si reference për llogaritjen e fondit limit në datën 19.01.2026,

Argumentimi: Keto dy kritere janë vendosur në bazë të nenit 45, pika 2, të VKM-se 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar ku parashikohet se:

“2.1. Për furnizimin me karburant, gazoil, benzol dhe karburant për ngrohje, në rastet kur oferta ekonomike më e favorshme bazohet në çmimin më të ulët, ky i fundit përllogaritet bazuar në:

- a) çmimin e bursës, lëvruar sipas kushtit CIF-Shqipëri, i cili dërgohet për publikim çdo javë nga Drejtoria e Përgjithshme e Doganave në Buletinin e Njoftimeve Publike;
- b) elementet fiskale;
- c) normën e fitimit të shprehur në vlerë absolute, e cila duhet të jetë e pandryshuar gjatë gjithë kohës së zbatimit të kontratës”.

ARGUMENTIMI I SPECIFIKIMEVE TEKNIKE:

Njesia pergjegjese ka hartuar/konfirmuar specifikimet teknike, ne te cilet thekson se jane shprehur qarte kerkesat AK per realizimin e kontrates.

Njesia pergjegjese ne hartimin/konfirmimin e specifikimet teknike argumenton se nuk ka permendur asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve, në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 39, pika 2, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, duke argumentuar çdo kërkesë funksionale ose performance, apo/dhe çdo standard të kërkuar, ku çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”.

NJESIA E PROKURIMIT